131

# VATRA E RINIS

**Revistë për Fëmijë**

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
ΑΡΧΕΙΟ ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΑ
Αρ. Εγγρ.: 11(40)

Tiranë, me 17 Maj 1936

Fort i ndershem e i dashuri im ungj,

Që kur se mora letrë-përgjigjen t'uaj, pas letrës s'ime ka disa muaj, nuk ju kam shkruajtur më, se s'kam patur as rast as arsye. Vetëm ju kam dërguar një librë t'emin, Kalendarin Enqiklopedik të v. 1936, bashkë me urime për vitin e ri dhe asnjë përgjigje s'kam marrë. As e di mirë se ku qëndroni, por nga njerëzit t'anë të fshatit kam mësuar se ju kini dërguar letra nga Athina dhe atje po ua drejtonj këtë letrë.

Me shëndet ndodhem mirë me tërë familjen t'ime. Sa për punë, po luftonj "εἰς τὸν σκληρὸν ἀγῶνα τοῦ βίου", mbetur pa përkrahje këtu në kryeqytet. Më ndihmon vetëm simpathia që kam fituar këtu me sjelljet e mia të nderçme dhe durimi em në punë.

Nuk di ç'bëni juve tani. Dhe rasti që më shtyn t'ju shkruanj sot ësht ay që ju përket juve. Kisha jonë këtu po kalon një fazë reformimi. Kryepiskopi Vissarion po ep dorëheqjen këto dit, i shtytur nga arsye e ndodhina të ndryshme që s'mund t'i përmend këtu. Kush do t'ja zërë vendin nuk dihet. Ësht folur dhe për juve. Nga sa flitet, kryesinë do t'a marrë përkohësisht Episkopi Kristofor Kisi, si zëvendës gjer sa Kongresi të zgjedhë kryetarin e rregullshëm. Tjatër nuk di që më tepër për juve. A kini ndonjë informatë për këtë punë? Dhe ç'mendoni? Un

mendoj se po te doni te perfitoni nga ky rast duhet te interesohi. Mund t' i shkruani mikut t' uej Vangjel Turtulli q' osht nje nga inisiatoret e levizjes per kete reformim kishtar si dhe mua qe te di ç' te benj.

Ne qofte se kini vendosur te mos tundi q' andej po perserit shpresat qe kam mbeshtetun mbe juve qe te m' i gjeni vend ne nonje shkolle atje vajzes s' ime me te madhe. Tjater bezdi s' ju kam dhene me gjith qe jam ndodhur nen rasjet me te kritikeshme dhe ndodhem akoma, por te pakten kete perkrahje qe mund t' a beni me perpjekje morale e pres nga juve. Sido qofte pres nje pergjigje.

Ime shoqe dhe femija ju puthim doren.

Me perimallim

Nipi juaj

V. Llaçka

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΑΚΗ ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ